



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



DREJTORATI I INSPEKSIONIT

Datë :	06.05.2025
Referencë	11-344/4
Për :	Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës
Kopje:	Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës
Kopje:	Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës
Nga:	Flamur Sylejmani-Drejtori i Inspeksionit
Lënda :	Raporti i muajit-prill

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Gjatë muajit prill Drejtoria e Inspektoratit ka ndjekur agjendat e caktuara dhe ka realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës, duke përfshirë të gjitha lokalitetet në territorin e Komunës tonë.

Inspektorët e tregut- gjatë muajit prill kanë inspektuar biznese të ndryshme afariste, objektivi i inspektimit ka qenë regjistrimi i bizneseve, pranimi teknik i lokaleve në të cilat realizohet veprimtari biznesore, urdhëresat për pranim teknik, si dhe realizimi i pranimeve teknike të cilat i plotësojnë kushtet për te ushtruar aktivitetin biznesor. Gjithsej janë realizuar 11 pranime teknike. Gjithashtu është kontrolluar për çmimin e artikujve, përputhshmërinë e çmimeve raft-arkë si dhe vendosjen e flamujve të cilët tregojnë origjinën e mallit.

Në bizneset të cilat kemi hasur parregullsi është iniciuar procedurë kundërvajtësve në Gjykatën Themelore në Prishtinë-dega Lipjan.

Në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” janë identifikuar dhe janë ndaluar disa persona të cilët ushtronin veprimtari ilegale brenda hapësirave të Aeroportit, të dhënies me qira të veturave për pasagjerët të cilët e frekuentonin Aeroportin, ndaj të cilëve janë marr masa dhe janë shqiptuar gjoba mandatore.

Gjatë muajit prill është bërë inspektimi i tregjeve si: tregut të gjelbër, kafshëve dhe mobileve.

Inspektori i mjedisit-ambientit- Sipas rregullores komunale, për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike janë inspektuar dhe urdhëruar të gjitha bizneset në qytet që shfrytëzojnë hapësirën publike që të marrin pëlqim për hapësirën në shfrytëzim nga drejtoria përkatëse e komunës. Bizneset kanë aplikuar për marrjen e pëlqimit nga drejtoria përkatëse. Në ditët në vazhdim do të bëhet rikontrollë se është zbatuar urdhëresa e dhënë. tek të gjitha bizneset u përpara lokaleve, e të pajisen me pëlqim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike nga muaji prill për hapësirën publike në shfrytëzim në të kundërtën ta lirojnë hapësirën publike.

Janë inspektuar dy gurore, njëra mbi fshatin Sllovi dhe tjetra afër fshatit Vrellë të Gadimës. Inspektimi është për shkak ngritjes së pluhurit gjatë qarkullimit të kamionëve në rrugën me zhavorr. Operatorëve në fjalë ju është dhënë urdhëresë që ta ujitin rrugën e pa asfaltuar mbi fshatin. Smallushë dhe Sllovi që mos të ketë ndotje të mjedisit me pluhur gjatë qarkullimit të kamionëve

Janë inspektuar disa deponi ilegale të mbeturinave, për të marrë masa ligjore ndajë ndotësve të cilët takohen apo gjeten dëshmi për ndotjen e bërë. Janë gjetur dëshmi të një biznesi për mbeturinat hedhura në kodrën e Kërçevës. Ndaj biznesit janë zhvilluar të gjitha procedurat ligjore dhe është urdhëruar që të largoj mbeturinat, urdhëresa është zbatuar.

Sipas ankesave të pranuar janë shqyrtuar dy raste: Në Dobrajë të Madhe ankesë për vendosje të koshit të mbeturinave (për letra dhe kartonë), marketit ushqimorë i është dhënë urdhëresë për largimin e koshit të mbeturinave nga prona publike.

Sipas ankesave të Kostt, ku ankesa ishte për shkak të rrezikimit të nënstacionit 110 Kv, në Lipjan si pasojë e mbushjes së parcelave (pronave) përreth Kostt dhe rrezikut nga uji si pasojë disnivelit, janë ndaluar për mbushjen e parcelave afër nënstacionit, Të dy pronaret ju është ndaluar mbushja e parcelave me material dheu.

Janë inspektuar objektet në ndërtim e sipër në Lipjan, në Rr. “Shaqir Hoxha” në lidhje me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore komunale, tek investitorët nuk janë gjetur parregullsi.

Inspektorët e trafikut- Në këtë muaj janë kontrolluar disa kompani të cilat kanë kontrata publike korniz nga Drejtoria e Arsimit për bartjen e nxënësve nga fshatrat, lagjet deri të Shkollat dhe anasjelltas, ku secilën prej kontratave e kemi inspektuar në vendin e ngjarjes aty ku i marrin dhe i zbresin nxënësit e klasave të ndryshme nga niveli parashkollor deri tek klasët më të larta, janë kontrolluar për numrin e nxënësve dhe auto-mjetin bartjes së nxënësve.

Janë kontrolluar firmat të autobusëve, auto-taksive, radio taksive, autobusët janë inspektuar për rend të udhëtimit, dhe janë urdhëruar që të respektohet rendi i udhëtimit.

Në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” është inspektuar vazhdimisht dhe janë mbajtur kujdestari me orare të ndryshuara për taksit ilegal dhe për firma të radio taksit që marrin pasagjer pa porosi si dhe për renta.

Në këtë muaj kemi zhvendosur edhe auto-taksit e qytetit të cilët kanë qenë të vendosur në rrugën Lidhja e Prizrenit ku ka pasur ankesa të ndryshme, i kemi vendosur auto-taksit e qendrës në rrugën “Gjergj Fishta”, auto-taksit tek shtëpia e kulturë në relacionit për Ribar i kemi vendos në rrugën “Shën Flori” sipas vendimit nga komisioni i përberë për caktimin e vend parkingjeve për auto-taksit në qytet.

Inspektori i ndërtimit- Inspektori i ndërtimit gjatë këtij muaji ka inspektuar në teren objektet të ndryshme ndërtimi përgjatë zonave urbanistike, si dhe janë realizuar vizita inspektuese me kërkesë të ndërtuesve për fazat ndërtimore.

Janë inspektuar objekte të cilat posedojnë leje ndërtimi dhe është konstatuar gjendja e tyre me procesverbal si dhe ndaj ndërtimeve të filluara pa leje ndërtimi është konstatuar gjendja me procesverbal dhe aktvendim për ndalimin e punëve dhe vendosjen e shiritave zyrtar. Pra, nga inspektori i ndërtimit janë realizuar, procesverbale, fletëparaqitje dhe vendosje të shiritave, gjoba mandatorë si dhe një kallëzim penal..

Drejtoria e Inspektoratit është përgjegjës në të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit prill janë:

Janë realizuar urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste si dhe janë bërë pesë pranime teknike të lokaleve afariste.

Ndalimi i shitjes jashtë tregut.

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Vendosje të shiritave zyrtar.

Fletëparaqitje.

Gjoba mandatore.

Aktvendime.

Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë.

Inspektim për kushtet e LMK-së dhe zbatimin e tyre ndaj investitorëve të objekteve me shumë njësi banimi.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspekte	Inspekte me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje	Njoftime nga DPMUMM-ja	Pranim teknik me komision (projekte komunale)	Vendosje të shiritave	Vërejtje, njoftime	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuar	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjyqësore	Konfiskim i targave, librezës dhe kthim	Gjoba mandatore	Te hyra nga pranime teknike	Inspektim i bizneseve pa pranime teknike	Menaxhim i tregeve	Aktivendime, ndalesa, urdhëresa	Inspekte për leje Mjedisore Komunale	Inspektim me polici	Inspektim i bizneseve pa regjistrim
Biznesi	151	26	11	1					57	8	1		4	150.00€	8	9	14		8	4
Ambienti	53	12							13								26	2		
Ndërtimi	57	16			22		2		2	13			1				1			
Trafiku	78	15		1				33	14	1						8			6	
Gjithsej	339	69	11	2	22		2	33	86	22	1		5	150.00€	8	17	41	2	14	4

DISKUTIMET PUBLIKE

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

TAKIME TË TJERA

Takimet janë mbajtur me pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë dhe qytetarë të tjerë.

SFIDAT

Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore.

Inspektimi i bizneseve të paregjistruara, pa pranime teknike.

Ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore, mbrojtja e hapësirave gjelbëruese.

Inspektime të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

REKOMANDIMET

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit.